# Republika e Kosovës
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*


**Nr. 01/02**
**Datë: 20.02.2026**

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 9 të Ligjit Nr. 06/L-059 për Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 shkurt 2026, merr këtë:

## V E N D I M

1. Themelohet Këshilli Shtetëror për manifestimin gjithëpopullor për shënimin e Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cila do të mbahet më datë: 5, 6 dhe 7 mars 2026, në këtë përbërje:

    1.1. Z. Ejup Maqedonci, Ministër i Mbrojtjes, kryesues;
    1.2. Z. Andin Hoti, Ministër për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare bashkëkryesues;
    1.3. Z. Sami Lushtaku, Kryetar i Komunës së Skenderajt, anëtar;
    1.4. Znj. Saranda Bugujevci, Ministre e Kulturës dhe Turizmit, anëtare;
    1.5. Z. Elbert Krasniqi, Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal, anëtar;
    1.6. Z. Bashkim Jashari, Komandant i Forcës së Sigurisë së Kosovës, anëtar;
    1.7. Z. Gazmend Hoxha, Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, anëtar dhe
    1.8. Përfaqësues nga Organizatat e Dala nga Lufta e UÇK-së, anëtar.

2. Ftohen ta dërgojnë nga një përfaqësues:

    2.1. Zyra e Presidentes;
    2.2. Kuvendi i Kosovës;
    2.3. Zyra e Kryeministrit;
    2.4. Asociacioni i Komunave të Kosovës.

3. Këshilli mund t'i themelojë grupet punuese relevante për arritjen e objektivave të tij.

4. Obligohen Këshilli Shtetëror dhe institucionet përkatëse për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 02/02
Datë: 20.02.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 shkurt 2026, merr këtë:

# V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive.
2. Obligohen Zyra e Kryeministrit, të gjitha ministritë dhe institucionet e tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 03/02
Datë: 20.02.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 shkurt 2026, merr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet Programi i Projektligjeve të Qeverisë për vitet 2026 - 2028.

2. Obligohen Zyra e Kryeministrit dhe ministritë për zbatimin e Programit nga pika 1. e këtij Vendimi.

3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Programin nga pika 1. të këtij Vendimi t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 04/02
Datë: 20.02.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 shkurt 2026, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Programi për Vlerësimin Ex-Post të Akteve Juridike për vitin 2026.

2. Obligohen Zyra e Kryeministrit dhe ministritë për zbatimin e Programit nga pika 1. e këtij Vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 05/02
Datë: 20.02.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 shkurt 2026, merr këtë:

# V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për Qasje në Arsimin e Lartë dhe Pranim për Studime, në Ballkanin Perëndimor.

2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 06/02
Datë: 20.02.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 shkurt 2026, merr këtë:

# V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Amendamentit Nr. 2 të Marrëveshjes Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, për Programin IPA 2017, pjesa e parë.

2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 07/02
Datë: 20.02.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 shkurt 2026, merr këtë:

## V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Amendamentit Nr. 3 të Marrëveshjes Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, për Programin IPA 2018.

2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 08/02
Datë: 20.02.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 shkurt 2026, merr këtë:

# V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave.

2. Obligohen Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe institucionet e tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij Vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 09/02
Datë: 20.02.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 6 të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2013 mbi Kriteret për Krijimin e Ndërmarrjeve Publike Lokale dhe Pjesëmarrja e Komunave në Bordet e Drejtorëve të Ndërmarrjeve Rajonale të Ujit, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 19/2015, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 shkurt 2026, merr këtë:

## V E N D I M

1. Themelohet Ndërmarrja Publike Lokale "Fushë Kosova" Sh. A., Fushë Kosovë, me 100% Aksione të Komunës së Fushë Kosovës.

2. Komuna e Fushë Kosovës autorizohet që të veprojë në emër të aksionarit të vetëm në NPL "Fushë Kosovë" Sh. A. dhe t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme, duke përfshirë regjistrimin sipas Ligjit Nr. 02/L-016 për Shoqëritë Tregtare.

3. Komuna e Fushë Kosovës, të drejtat e saj të aksionarit do t'i ushtrojë nga Komisioni Komunal i Aksionarëve në emër të Komunës përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Obligohet Komuna e Fushë Kosovës për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- KK Fushë Kosovë
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 10/02
Datë: 20.02.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 6 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2013 mbi Kriteret për Krijimin e Ndërmarrjeve Publike Lokale dhe Pjesëmarrja e Komunave në Bordet e Drejtorëve të Ndërmarrjeve Rajonale të Ujit, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 19/2015, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 shkurt 2026, merr këtë:

# V E N D I M

1. Themelohet Ndërmarrja Publike Lokale "Eko Drenasi" Sh. A. Gllogoc, me 100% aksione të Komunës së Gllogocit.

2. Komuna e Gllogocit autorizohet që të veprojë në emër të aksionarit të vetëm në NPL "Eko Drenasi" Sh. A. dhe t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme, duke përfshirë regjistrimin sipas Ligjit Nr. 02/L-016 për Shoqëritë Tregtare.

3. Komuna e Gllogocit, të drejtat e saj të aksionarit do t'i ushtrojë nga Komisioni Komunal i Aksionarëve në emër të Komunës përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Obligohet Komuna e Gllogocit për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- KK Gllogoc
- Arkivit të Qeverisë

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 11/02**
**Datë: 20.02.2026**

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 shkurt 2026, merr këtë:

## V E N D I M

**Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/64, të datës 25 shkurt 2022 "Për zbatimin nga Republika e Kosovës të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për vendosje të sanksioneve ndaj Federatës Ruse dhe Bjellorusisë, në raport me situatën në Ukrainë"**

1. Pika 1. e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/64, të datës 25 shkurt 2022, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim: Qeveria e Republikës së Kosovës zbaton sanksionet e vendosura nga Këshilli i Bashkimit Evropian përmes:

    1.1. Rregullores (BE) Nr. 833/2014 për masat kufizuese në lidhje me veprimet e Rusisë që destabilizojnë situatën në Ukrainë, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren e Këshillit (BE) 2025/2033 (23.10.2025) dhe Rregulloren e Këshillit (BE) 2025/2618 e 18 dhjetorit 2025, si dhe Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2026/124 e 14 janarit 2026, si dhe Vendimit 2014/512/CFSP për masat kufizuese në lidhje me veprimet e Rusisë që destabilizojnë situatën në Ukrainë, të ndryshuar dhe të plotësuar me Vendimin e Këshillit (CFSP) 2025/2032 (23.10.2025), Vendimin e Këshillit (CFSP) 2025/2617 i 18 dhjetorit 2025 dhe Vendimin e Këshillit (CFSP) 2025/2648 i 22 dhjetorit 2025.

    1.2. Rregullores (BE) Nr. 269/2014 për masat kufizuese në lidhje me veprimet që dëmtojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës, e zbatuar, e ndryshuar dhe e zgjeruar me Rregulloren Zbatuese të Këshillit (BE) 2025/2035 (23.10.2025), Rregulloren Zbatuese të Këshillit (BE) 2025/2037 (23.10.2025) dhe Rregulloren Zbatuese të Këshillit (BE) 2025/2588 e 15 dhjetorit 2025, si dhe Vendimit 2014/145/CFSP për masat kufizuese në lidhje me veprimet që dëmtojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës, të ndryshuar dhe të plotësuar me Vendimin e Këshillit (CFSP) 2025/2036 (23.10.2025) dhe Vendimin e Këshillit (CFSP) 2025/2594 i 15 dhjetorit 2025.

    1.3. Rregullores (EC) Nr. 765/2006 për masat kufizuese në lidhje me situatën në Bjellorusi dhe përfshirjen e Bjellorusisë në agresionin rus kundër Ukrainës, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren e Këshillit (BE) 2025/2041 (23.10.2025), Rregulloren Zbatuese të Këshillit (BE) 2025/2039 (23.10.2025) dhe Rregulloren e Këshillit (BE) 2025/2601 e 15 dhjetorit 2025, si dhe Vendimit 2012/642/CFSP për masat kufizuese në lidhje me situatën në Bjellorusi dhe përfshirjen e Bjellorusisë në agresionin rus kundër Ukrainës, të zbatuar me Vendimin Zbatues të Këshillit (CFSP) 2025/2038 (23.10.2025) dhe të ndryshuar dhe të plotësuar me Vendimin e Këshillit (CFSP) 2025/2040 (23.10.2025).

2. Të gjitha llojet e sanksioneve, si dhe emrat e individëve, entiteteve dhe produkteve të sanksionuara përmes akteve ligjore të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe anekseve përkatëse të përmendura në pikën 1. konsiderohen pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

3. Masat shtrënguese/kufizuese do të jenë në fuqi, deri në një Vendim tjetër dhe varësisht nga rrethanat mund të përditësohen, të plotësohen apo të ndryshohen.

4. Obligohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 12/02**
**Datë: 20.02.2026**

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenet 62 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 shkurt 2026, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 04/54, i datës 12 janar 2022 (këtu e tutje referuar si: Vendimi), si vijon:

    a) Paragrafi 1. i Vendimit zëvendësohet me tekstin e ri si vijon: Themelohet Zyra për Ekspertizë, Zbatim dhe Mbikëqyrje Strategjike, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (këtu e tutje referuar si: Zyrë).
    b) Paragrafi 2. mbi Detyrat dhe Përgjegjësitë kryesore të Zyrës ndryshon si në vijim:

    - Angazhimi i ekspertizës për nevoja të dikastereve të Qeverisë,
    - Sigurimi i zbatimit të Planit të Punës të Qeverisë përmes ekspertizës,
    - Mbikëqyrja e zbatimit të projekteve kapitale dhe programeve të parapara me Planin e Punës të Qeverisë,
    - Sigurimi i zbatimit të kontratave të nënshkruara, në veçanti të atyre të projekteve kapitale,
    - Rekomandime Kryeministrit dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës mbi marrjen e masave për të siguruar zbatimin e projekteve e të programeve të parapara me Planin e Punës së Qeverisë, dhe
    - Detyra të tjera të deleguara nga ana e Kryeministrit dhe e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

2. Paragrafët 3, 4 dhe 5 fshihen.

3. Zyra funksionon në bazë të Rregullores së Punës së Qeverisë dhe Ligjit mbi Ndarjet Buxhetore.

4. Paragrafi 6 riformulohet si vijon: Zyra do të përbëhet nga ekspertët e angazhuar dhe stafi mbështetës i udhëheqësit të Zyrës, konkretisht asistentë dhe shofer.

5. Zyra udhëhiqet nga i autorizuari i Kryeministrit, i cili i raporton direkt Kryeministrit.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë